



11/28/01/25.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

AKT KONSTATIMI

I mbajtur sot më datë 16.12.2024 në zbatim të shkresës nr. 15484 prot, datë 11.11.2024, ndërmjet Grupit të Auditimit të ngritur për kqyerjen e zbatimit të rekomandimeve, të lëna në auditimin e mëparshëm në Shoqëritë Huamarrëse në Administrim.

Në zbatim të pikës iv, të gurmës "ç", të nenit 14 të ligjit nr.114 datë 06.11.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". të gurmës "ç" të pikës 10, të Urdhërit të Ministrit Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 13.02.2017 "Për kqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm", z. Flori ALLA, z. Latif ÇELA dhe znj. Nensi XHANI, kanë kryer kqyerjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm në Shoqëritë Huamarrëse në Administrim. Plan i veprimit është përcjellë Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 1047/5 prot, datë 13.05.2024.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton si më poshtë:

Rekomandimi nr.1: Të hartohet rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të shoqërisë duke përfshirë të gjitha rregullat për mirëfunksionimin e saj, si ndarjen e detyrave/përshtkrimet për çdo pozicion pune, mënyrën e vlerësimit të rezultateve në punë për stafin, linjat e raportimit, qarkullimin e dokumentacionit, afatin dhe autoritetin ku do raportohet raporti vjetor i veprimtarisë së shoqërisë.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Shoqëria Huamarrëse në Administrim ka hartuar Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj dhe e ka dërguar për miratim tek Ministri i Financave me shkresën nr. 119 prot, datë 07.06.2024.

Rekomandimi nr.2: Shoqëria të identifikojë risqet e institucionit që ndikojnë në realizimin e objektivave dhe të hartojë regjistrin e riskut dhe planin e monitorimit të tyre.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Shoqëria Huamarrëse në Administrim ka identifikuar risqet dhe ka hartuar regjistrin e riskut.

Rekomandimi nr.3: Për asetet të cilat kanë dalë disa here në ankand dhe nuk janë shitur, dhe që plotësojnë kushtet për rivlerësim, shoqëria huamarrëse në Administrim të bëjë rivlerësimi i tyre dhe ti ridërgojnë për shitje në ministri.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Me anë të shkresës nr. 101 prot, datë 17.05.2024, Shoqëria Huamarrëse në Administrim ka ridërguar pranë Ministrisë së Financave 4 objekte për shitje.

Rekomandimi nr.4: Për pronat të cilat figurojnë të regjistruara në hipotekë, por që fizikisht nuk ekzistojnë, Shoqërisë Huamarrëse në administrim të zbatojë procedurat ligjore për heqjen nga pasuria e Shoqërive në Administrim të aseteve të cilat nuk ekzistojnë fizikisht.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Komisioni i Shoqërive Huamarrëse në Administrim ka verifikuar gjendjen e pronave të cilat figurojnë të regjistruara në ASHK, por që fizikisht nuk ekzistojnë. Sipas procesverbaleve të mbajtura në datën 25.11.2024, Komisioni ka sugjeruar që ndërtesat të hiqen nga inventari dhe ASHK, ndërsa trualli të vlerësohet nga ekspertët vlerësues dhe të dërgohet për shitje.

Rekomandimi nr.5: Administratori i Shoqërive Huamarrëse në Administrim, të vazhdojë të shfrytëzojë të gjitha hapësirat ligjore për të bërë të mundur rikthimin e vlerave financiare të aseteve që ndodhen jashtë vendit.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Me anë të shkresës nr. 234 prot, datë 15.11.2024, Administratori i Shoqërive Huamarrëse në Administrim ka kërkuar informacion nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me ecurinë për kthimin e vlerave financiare për llogari të Shoqërive Huamarrëse në Administrim.

Rekomandimi nr.6: Specialisti i financës të bëjë çiftosjen e dokumentacioneve duke bashkëlidhur urdhër transfertave dokumentacionin e saj shoqëruar/justifikues të pagesës së kryer, sipas rregullave në fuqi.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Nga verifikimi i dokumentacionit të muajit korrik, shtator dhe nëntor 2024, rezulton se është bërë çiftosja e dokumentacionit vërtetues bashkëlidhur Urdhër Transfertave.

Rekomandimi nr.7: Të bëhet sistemimi i diferencave të konstatuara në pagesën e pagës së punonjësve (arkëtime/ose pagesa), si dhe të bëhet verifikimi i borderove/pagesave të pagës dhe për periudhën nën auditim, si dhe të bashkëlidhet dokumentacioni sqarues/justifikues për çdo veprim të kryer.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Specialisti i financës ka kryer rakordimet në lidhje me pagesën e pagave të punonjësve dhe për çdo rast ka vendosur shënimet përkatëse sqaruese të veprimeve të kryera, si

dhe janë mbajtur diferencat nga paga e muajit prill 2024. Gjithashtu u kontrolluan pagesat e punonjësve të muajit tetor 2024 dhe nuk u konstatuan parregullsi.

Rekomandimi nr.8: Të kryhen rakordimet mujore/vjetore me bankat e nivelit të dytë për llogarinë me të cilën kryhen shpenzimet administrative të Shoqërisë huamarrëse në administrim, si dhe të administrohet nga shoqëria (financa) në çdo fund viti nxjerrja e llogarisë vjetore (statementi) nga banka.

Statusi: Rekomandimi vlerësohet i realizuar.

Koment: Nga verifikimi i dosjve të muajit shtator, tetor dhe nëntor 2024, rezulton se specialisti i financës ka kryer rakordimet me bankat e nivelit të dytë.

Konkluzione mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga njësia e audituar.

Grupi i auditimit arrin në konkluzionin se: nga 8 rekomandime të pranuar gjithësej, nga mbikëqyrja e tyre rezultojnë me statusin “Realizuar” 8 rekomandime.

Grupi i auditimit falenderon me këtë rast subjektin e audituar për bashkëpunimin.

Për grupin e auditimit

Flori ALLA

Latif ÇELA

Nensi XHANI

Për Shoqëritë Huamarrëse në Administrim

ADMINISTRATOR

Lejda

